

STATUT

I PERSONIT JURIDIK SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "BIS" sh.p.k.

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512, datë 10.08.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit".

Në përputhje me Ligjin nr. Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, sot më datë 25/03/2021 , krijohet shoqëria tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin:

"BIS" sh.p.k.

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Emërtimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "BIS" sh.p.k.

Neni 2 Forma Juridike

Shoqëria "BIS" sh.p.k., është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga ortaku i vetëm, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri ne pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të këtë filluar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretë, për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 3 Ortakët e shoqërisë

OrtakuThemelues i Shoqërisë është z. Eno Serjanaj, i datëlindjes 09/08/1986, lindur në Berat dhe banues në Berat, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftmin (ID) Nr. 034509915, zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë të përgjithshme 1'000 (njëmijë) Lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.



Ortakët përgjigjen për detyrimet dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë, deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 4 **Selia dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria e ka selinë në adresën: L. 30 Vjetori, Rr. Ndërtuesi, Godinë 1-Katëshe, Nr. 2/2, Berat 5003, Shqipëri. Z.K. 8502, me numër pasurie 14/13. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakut të Vetëm.

Vula e shoqërisë përmban emërtimin i shoqërisë dhe NUIS-in e shoqërisë dhe kontakte të tjera opsionale.

Neni 5 **Objekti**

Shoqëria "BIS" sh.p.k., ka për objekt:

"Kryerjen e çdo aktiviteti të lejuar me ligj dhe/o pjesëmarrjen në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryej një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi. Aktivitet në fushën e projekteve, mbikqyrjes e kolaudimeve, auditimeve, ndikimeve e vlerësimeve dhe hapje studio projektimi, auditimi, ndikimi, e vlerësimi, investitor privat dhe/ose zbatues i veprave të ndërtimit, rikonstruksionit, restaurimit, mirëmbajtje, sipërmarrje të ndryshme me fonde private dhe shtetërore, donacione, etj., shërbime ndërtimi faqe WEB, printimi, dizajni dhe montimi, marketingu, marketingu online, në fushën e projektimit, e auditimit, e mjedisit, e mbrojtjes kundër zjarrit dhe e ndërtimit të objekteve të ndryshme civile, industriale, social-kulturore, turistike, bujqësore, landfill-eve, stadiumeve, punime sipas kategorive të licencës së zbatimit:

NP-1, NP-2, NP-3, NP-4, NP-5, NP-6, NP-7, NP-8, NP-9, NP-10, NP-11, NP-12, NS-1, NS-2, NS-3, NS-4, NS-5, NS-6, NS-7, NS-8, NS-9, NS-10, NS-11, NS-12, NS-13, NS-14, NS-15, NS-16, NS-17, NS-18, NS-19, NS-20.

Agjenci shit-blerjen pasurive të luajtshme dhe paluajtshme. Punime mjedisore, hartim raporteve ndikimit mjedis dhe ekspertime mjedisore. Grumbullim, ruajtje, transportim dhe trajtimi mbetjeve urbane dhe mbetjeve inerte parrezikshme. Shërbime dërgesash brenda jashtë Shqipërisë për transport mallrash të ndryshme me shumicë e pakicë, import-eksport me mjete të shoqërisë. Import-eksport, tregtim me shumicë-pakicë i mallrave dhe pajisjeve të ndryshme industriale, bujqësorë, blegtorale, elektrike, hidraulike, frigoriferike, ashensor, elektroshtëpiake, industriale, kancelari dhe artikujve shkollor, ushqimore, pajisjeve të kondicionimit dhe ventilimit, kompjutera dhe pajisje kompjuterike, printimi, fotokopjimi, stampimi dhe pjesë këmbimi, si dhe të ofrojë gjitha shërbimet/riparime që kryhen me pajisjet sipërpërmendura. Import, eksport dhe tregtim, shumicë dhe pakicë lëndës së parë, të makinerive, mjete, automjete, kamionë, makineri industriale, bujqësore, blegtorale, si dhe çdo lloj mjeti dhe pajisje të motorizuar dhe pjesë këmbimit për këto, autoservisin e mjeteve markave e tonazheve të ndryshme. Dhënie me qira e mjeteve dhe automjeteve të çdo lloji. Krijimi, instalimi, dhënia me qira dhe vënia në shfrytëzim e impianteve, stacioneve, reparteve, linjave për tregtimin hidrokarbureve brenda e jashtë vendit: Import-eksport dhe tregti me shumicë pakicë naftës, gazit. nënprodukteve të tyre, vajrave lubrifikantë, transport kombëtar e ndërkombëtar i tyre. Ndërtimi, marrja dhe dhënia me qira dhe vënia në përdorim të depove

hidrokarbure, rezervuarëve të linjave dhe pikave të shitjes së tyre sipas projektit teknologjik. Shërbim hoteleri. Agjenci turistike. Import-eksport, prodhim dhe tregtimi materiale ndërtimi dhe lëndëve të para industrial, drusore dhe për ndërtim. Hotel, bar-kafe, restorante. Import, eksport dhe tregtim, me shumicë dhe pakicë të mjeteve mjekësore, aparaturave dhe pajisjeve mjekësore, mjeteve farmaceutike; materialeve/lëndëve/produkteve/barnave farmaceutike dhe veterinerë. Funksionimi dhe administrimi i farmacive të shitjes me pakicë dhe tregtimi me pakicë i barnave dhe produkteve farmaceutike. Organizimi, veprimtaria dhe menaxhimi i strukturave diagnostikuese dhe kuruese dhe qendrave ambulatorë të diagnostikimit në territorin e Shqipërisë. Trajtimi i mbetjeve spitalore. Aktivitet në fushën e edukimit parashkollor, privat, çerdhe, kopsht, aktivitetet mësimdhënëse në fushën e arsimit e ciklit të ulët 9-vjeçar, arsimit të mesëm të profilizuar dhe të përgjithshëm dhe arsimit të lartë, kurse kualifikimi në gjuhë të huaj, etj. sipas kërkesës/ofertës që do të ketë shoqëria nga subjekte të ndryshme private, juridike dhe shtetërore."

Neni 6 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Q.K.B.

KREU II KAPITALI

Neni 7 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 1'000 (nëmijë) Lekë dhe është nënshkruar nga "Ortaku Themelues" i shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme /të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë e gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 (tre) vjetëve nga çasti i cenimit.

Ky kapital do të ngurtësohet në Bankë pasi të dali NIPT-i i shoqërisë.

Neni 8 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit,

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 9

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shit-blerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve dhe të tretëve, apo me rrugë trashëgimie, për sa kohë nuk parashikohet ndryshe në statut.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim. Kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji, apo kur palët blen dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

KREU III

ORGANET VENDIM-MARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 10

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve

Asambleja e Përgjithshme të Ortakëve (më poshtë e quajtur "AP") në rastin e shumë ortakëve ose në rastin e vetëm një ortaku, "Ortaku i Vetëm" (më poshtë e quajtur "OV") është organi vendim-marrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Q.K.B.-së për të pasqyruar ndryshimet në regjistrin tregtar.

Ajo është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet e mëposhtme si:

1. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
2. ndryshimet e statutit;
3. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;



4. emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
5. përcaktimin e shpërblimeve
6. Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurisë së veprimtarisë;
7. përfaqësimin e shoqërisë ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
8. miratimin e rregullave proceduralë të mbledhjeve të asamblesë;
9. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
10. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
11. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
12. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
13. çështje të tjera të parashikuara nga statuti apo nga ligji;

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakeve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

1. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve te ecurisë së veprimtarisë;
2. shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
3. investime;

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundër drejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 11

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë apo njoftimit.

Neni 12

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 (tridhjetë) përqindje të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendos për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marr vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 13 Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me 3/4 (tre të katërtat) e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje të cilët zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave (shumicë të kualifikuar), për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës në mbledhje, që zotërojnë më shumë se 30% të numrit total të votave (shumicë të zakonshme), për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori/ët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit/ëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- h) emërimin e ekspertëve të pavarur për hetimin/auditimin financiar dhe juridik të shoqërisë sipas kërkesës së ortakut;
- i) çështje të tjera të parashikuara në nenin 81 të ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

- Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij.

- Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet nga Administratori pranë QKB-së për të pasqyruar ndryshimet në regjistrin tregtar.

Neni 14 Përfundimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënieve ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 15 Përfaqësuesi ligjor

"AP" zgjedh dhe emëron një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqërisë të cilët ushtrojnë detyrat e administrimit dhe përfaqësimit të shoqërisë, bashkërisht apo veç e veç, konform përcaktimeve në këtë statut dhe ligjeve të Republikës së Shqipërisë. Afati i emërimit, është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorit/ëve prodhon efekte, pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjellas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të "AP" ose "OV", në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Me kërkesë të ortakut të shoqërisë, administratori mund të shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit apo statutit të shoqërisë, pavarësisht vendimmarrjes së Asamblesë së Përgjithshme për shkarkimin apo jo të tij. Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë QKB-së.

Personi/at e mëposhtëm caktohen si Administrator i Parë i shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Administrator i shoqërisë "BIS" sh.p.k. është znjsh. Anxhela Çorosteni, e datëlindjes 11/12/1996, lindur në Berat dhe banuese në Berat, shtetase shqiptare, madhore, me zotësi juridike dhe për të vepruar, identifikuar me Letërnjoftm (ID) Nr. J66211055C, e cila do të ushtrojë funksionet në këtë detyrë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë ripërtëritje.

Neni 16 Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet:

1. të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
2. të përfaqësojë shoqërinë tregtare me të tretët, përpara organeve shtetërore, gjyqësore, personave fizikë dhe juridikë, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve, personalisht apo duke autorizuar me shkrim një person të tretë;
3. ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretet në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë;
4. të lidhë pa asnjë limit, çfarëdolloj marrëveshje civile, kontratë, prokurë, autorizim, të hapë llogari bankare dhe të kryejë veprime dhe transferta pranë bankave të nivelit të dytë brenda si dhe atyre jashtë Republikës së Shqipërisë;
5. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm.
6. të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregulltë të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

7. të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
8. të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
9. të kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç, parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
10. të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
11. të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në statut dhe në ligj;

Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e ortakut të vetëm edhe në rastet kur:

1. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojn ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim
2. shoqëria, brenda 2 (dy) viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 (pesë) përqindje, të aseteve të shoqërisë, që rezultojn në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
3. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyre tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 (pesë) përqindje, të aseteve të shoqërisë, që rezultojn në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Neni 17


Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga Asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidare sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1.
 - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
 - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të



rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
 - a) u kthen ortakeve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - d) lejon që shoqëria të vazhdoj veprimtarinë tregtare, kur, në baze të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - e) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblinin financiar, nëse është e nevojshëm. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.


Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretë kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke e patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 18 **Shpërblimi i administratorit**

Shpërblimit bazë të administratorëve mund t'i bëhen shtesa, që mund të jenë përqindje në fitim ose të ngjashme. Shpërblimet e administratorit përcaktohen me vendim me shumicë të thjeshtë të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Shpërblimi duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë

KREU IV **VITI FINANCIAR- EKSPERTËT**

Neni 19 **Viti Financiar**



Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 (një) Janar dhe përfundon me 31 (tridhjetë e një) Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 (tridhjetë e një) Dhjetor.

Neni 20 **Bilanci i shoqërisë dhe dividendët**

Brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori. Asambleja e Ortakëve vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar.

Neni 21 **Të ardhurat Neto**

Të ardhurat neto që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi ortakëve.

Neni 22 **Eksperti**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollat periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollat periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'jua paraqesë dhe t'ua dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar, e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që kanë.

Neni 23 **Fondet rezervë**


Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fonde të tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike. Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerjen e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

KREU V **PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISË**

Neni 24 **Prishja e shoqërisë**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë kur vërtetohen rastet e parashikuara në nenin 99 të ligjit nr. 9901 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare":

1. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
2. me vendim të asamblesë së përgjithshme;
3. me hapjen e procedurave të falimentimit;



4. nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me piken 3 të nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
5. me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Ortakëve e merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 (një) apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rastit kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 25

Likuidimi i shoqërisë dhe të drejtat e detyrimet e likuiduesit

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij, megjithatë likuiduesi i nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit të shoqërisë. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njeri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundër drejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit të sipërpërmendur.

Detyra e likuiduesit është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të pa arkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve, duke respektuar radhën e preferimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.


Nëse, në bazë të pretendimeve të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 195 të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së procedurave të likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave.

Nëse procedura e likuidimit zgjat me shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e procesit të likuidimit dhe kërkon ç' regjistrimin e shoqërisë, në përputhje me ligjin e posaçëm që rregullon veprimtarinë e Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 26

Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901, datë 14.04.2012 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".



Neni 27
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 28
Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lind midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


Neni 29
Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 ekzemplarë me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nën për nën nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare "BIS" sh.p.k. dhe nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

Berat, më 10.09.2021

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË
"BIS" sh.p.k.

Inxh. ENO SERJANAJ


(firma, vulë)